



EIKR

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" shpk**

Ne Tirane, sot me date 23.01. 2019, (dymije e nentembehjete), ne te nenshkruarit e meposhtem :

**Arti MALAJ**, atesia Nik, i datelindjes 10.06.1975, lindur ne Ivanaj, Shkoder dhe banues ne Shkoder, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit ID me nr. 032321136 dhe me nr. Personal H50610046S,

**Adriana BEQAJ**, atesia Bardhyl, e datelindjes 09.11.1966, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit ID me nr. 029052242 dhe me nr. Personal G66109067J,

*me cilesine e "Ortakeve te shoqerise", redaktojne kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklarojne se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ", me ndryshimet perkatese, ne ligjin "Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "**ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB**" shpk.*

**KREU I**

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emertimi**

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "**ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB**" shpk.

**Neni 2**

**Forma Juridike**

Shoqeria "**ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB**" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personi fizik i siperpermendur, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi te ketë fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te tretëve per detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqerise ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

**Neni 3**

**Selia**

Selia ligjore e Shoqerise ndodhet ne adresen **Rruga "Toptaneve", Kalaja e Tiranës, Tirane.** Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 4**





### **Objekti**

Hapje te aktivitetit bar- kafe- restaurant, veprimtari ne fushen e gastronomise, Import-Export, te artikujve te ndryshem, ushqimore, produkte bujqesore, blegtorale fruta perime prodhime te detit, pijeve freskuse e alkolike, te markave e llojeve te ndryshme, Shoqeria do te kryeje te gjitha veprimtarite tregetare, financiare qe lidhen me objektin kryesor te saj dhe qe gjykohet e nevojshme e te dobishme prej saj.

### **Neni 5**

#### **Kohezqatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

## **KREU II** **KAPITALI**

### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 leke** dhe eshte i perbere nga **2 kuota**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, në dy kuota me vlerë, qe perbejne 100% te kapitalit te shoqerise, qe zotërohet nga Ortaket i ndare ne dy kuota, si me poshte :

**Arti Malaj**, zoteruesi i 1 kuote, qe perben 50 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, me vlere te pergjitheshme 50.000 leke,

**Adriana Beqaj**, zoteruese e 1 kuote, qe perben 50 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, me vlere te pergjitheshme 50.000 leke

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723,





datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te paktën tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.





## **Neni 10**

### **Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga nje administrator.

Administrator i shoqërisë është **Elis Makaj, i datelindjes 03.11.1993, lindur ne Busha Shkoder dhe banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit ID Nr personal J31103077W** i cili do të ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe **5 vjecare me te drejte ripertesitje.**

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## **Neni 11**

### **Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblesën e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.





**Neni 12**

**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pa financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 13**

**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument tjetër nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper ".

**Neni 14**

**Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 15**

**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindë midis Shoqërise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 16**

**Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhe shqipe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga ortaket e shoqërise tregtare, nenshkruajne ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale, autenticiteti i të cileve vertetohet nga Noteri.

Ngarkohet 2-Elis Malaj per depozitim te ketyre akteve prane QKB.

**ORTAKET THEMELUES**

**ARTI MALAJ**

**ADRIANA BEQAJ**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NOTERE MAJLINDA LLESHI

Nr. 328 Rep.

Nr. 109 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 23.01 2019 (dymije e nentembedhjete) perpara meje **Majlinda Lleshi**, Noteres Publike, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Rruga "Sulejman Delvina", u paraqiten personalisht shtetasit me keto identitete :

**Arti MALAJ**, atesia Nik, i datelindjes 10.06.1975, lindur ne Ivanaj, Shkoder dhe banues ne Shkoder, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit ID me nr. 032321136 dhe me nr. Personal H50610046S,

**Adriana BEQAJ**, atesia Bardhyl, e datelindjes 09.11.1966, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit ID me nr. 029052242 dhe me nr. Personal G66109067J.

Me vullnetin e tyre të lire, të plote dhe të singerte, me cilesine e ortakeve themelues te shoqerise "**ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB**" shpk, kane redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, Aktin e Themelimit te mesiperm dhe deklarojne se e kane lexuar dhe e kane kuptuar gjithcka ne lidhje me kete akt dhe e nenshkruajne pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale ne kete zyre para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh neni 55 i Ligjit nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterine" i ndryshuar, ne Republikën e Shqiperise.

NOTERE

